



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi**

Datë: 08.01.2019

Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)

*Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).*

**A. Informacioni bazë**

Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Arben Zefi</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z. Arben Zefi</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Gjyqtar/Kryetar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor, Shkodër.</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor që ajo të shtyhej për shqyrtim të mëtejshëm.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Në fund të seancës dëgjimore trupi gjyqësor u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën vetëm për shpalljen e tij në datën 10.01.2019, ora 12:00.</i>

**B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca**

Trupa gjykuese (emrat)	<i>Kryesues: Firdes Shuli, Relator: Roland Ilia, Anëtar: Etleda Ciftja.</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (OMN): z. Ferdinando Buaer de Mongeot.</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Avokat: Ardian Visha</i>
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Amilda Celami</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u lejuan media, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, qytetarë të interesuar. Numri total i të pranishmëve varioje 25-30 persona.</i>
Media e pranishme:	<i>Gazetarë dhe operatorë të mediave të ndryshme ishin të pranishëm.</i>

<b>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</b>	<b>Pa/Jo</b>	<b>Nëse po, si u justifikua ai?</b>	<b>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</b>
	<i>KPK e bazoi gjykimin mbi dy kriteret (Vlerësimi i pasurisë, Kontrolli i figurës,)</i>		
<b>D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)</b>	<b>Argumenti</b>	<b>Kush e ka dhënë argumentin</b>	<b>A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?</b>
	<i>Raporti i ILDKPKI-së: Deklarim i saktë, burime të ligjshme financiare, subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, jo deklarim i rremë, nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.</i>	<i>Raporti nga ILDKPKI</i>	<i>Lidhur me gjykimin e kriterit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, relatori i çështjes, pohoi se hetimi ishte bazuar në</i>

<b>D1. Pasuria</b>	<p>Hetimi i thelluar dhe i pavarur i KPK-së ka nxjerrë përfundime kontradiktore me raportin e ILDKPKI-së:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Ap. Banimi 132.8m2 në Shkodër, vlera 4.835 milion lekë, fituar me kontratë shitblerje në vitin 2005. Burimi: nuk është deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit. KPK cilëson së subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme. Nuk ka deklaruar gjithashtu dhe shumën 1.9 milion lekë që ka shërbyer për blerjen e tij.</li> <li>2) Automjete BMW blerë në vitin 2007. Vlera dhe burimi: Të padeklaruar. KPK ka arritur në përfundimin se subjekti ka përdorur dokumente të parregullta për të provuar pronësinë e tij. Ka mospërputhje mes deklaramëve të tij dhe dokumentacionit të paraqitur.</li> <li>3) Automjet Benz, i peregjistruar, blerë në vitin 2010. Vlera: 500 mijë lekë. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e tij.</li> <li>4) Automjet Volkswagen Passat në huapërdorje, me të cilin është bërë shkëmbimi me automjetin Benz, për këtë KPK griti dyshime.</li> <li>5) Nga hetimi kanë rezultuar 50 mijë euro të marra kredi, shumë e cila i është kaluar një shoqërie ndërtimi për përfitimin e pasurive të paluajtshme. Me shoq. "S.M.O" subjekti ka bërë një marrëveshje verbale, nuk disponon dokumentacion provues. Pas disa kohësh ka tërhequr nga shoqëria, cash, shumën 45 mije euro. Rezulton që më parë subjekti ka shqyrtuar një padi të shoq "S.M.O".</li> <li>6) Depozitë 300 mijë lekë në Tirana bank</li> <li>7) Kartë debiti e përdorur nga i vëllai në Itali. Subjekti në lidhje më këtë ka bërë deklaram të pamjaftueshëm.</li> <li>8) Për vitet 2006,2007, 2009 rezulton bilanc negativ financiar.</li> <li>9) 100.000 euro marrë hua personit me iniciale R.D</li> <li>10) Nuk ka deklaruar pasuritë e përfituara nga bashkëshortja e tij.</li> <li>11) Përfitim i shumës 800 mijë lekë nga Enti i Banesave si i pastrehë, dyshohet nga KPK si përfitim i pajustificuar.</li> </ol>	Relatori i çështjes	<p>të dhënat e ardhura nga ILDKPKI, DSIK, hetimi administrativ i KPK-së, të dhënat e marra nga institucionet publike dhe nga shpjegimet e bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në bazë të rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit i ishte kërkuar të japë shpjegime/prova.</p>
	<p>Avokati Visha bëri ndërhyrjen e tij, duke cilësuar realitetin e vendit tonë të tillë, që më tepër anon tek marrëveshjet e mirëbesimit dhe verbale sesa ato noteriale. Lidhur me automjetin Benz model 320, nuk rezulton të jetë i vjedhur.</p>	Mbrojtja	
	<p>AP. Banimi 132.8m2 në Shkodër, vlera 4.835 milion lekë, subjekti deklaroi se ishte blerë nga janari 2004 deri më dhjetor 2005 me këste. z. Zefi në kundërshtim nga rezultat e hetimit të KPK-së e cilëson blerjen me një çmim real, standard për zonën dhe rezulton vlera 32.800 lekë për m2. Të ardhurat janë siguruar nga kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Për vitet 1998-2003 rezultojnë 3 milion lekë kursime nga paga e bashkëshortes tek Banka Kombëtare dhe 2 llogari të tjera tek Tirana Bank. Në janar 2004 - dhjetor 2005 rezultojnë 3 milion të ardhura nga pagat. Në vitin 2005 është shitur ap. banimi 1+1, 56m2 në vlerën 1 milion e 900 mijë lekë. KPK nuk e ka llogaritur këtë shumë parash gjatë hetimit të bërë. Subjekti cilëson që të gjitha të ardhurat e tyre janë lehtësisht të verifikueshme. Për vitet 2004-2005, z. Zefi i trajtoi si vite të begata financiarisht me dy fish të ardhura, në total 7.390.563 lekë. Lidhur me shumën prej 800 mijë lekë të përfituar nga Enti i Banesave, pohoi si një përfitim të merituar, bonus që bashkia, në vitin 1994, jepte për familjet e pastreha, shumë e dhënë për frymë. Subjekti iu referua edhe ligjeve dhe VKM konkrete. Lidhur me automjetin Benz 320, viti 2006 i papërdorur, i është dhënë me premtimin për t'u shitur. Nuk e ka deklaruar në Deklaratën periodike Vetting 2007-2008 pasi në vitin 2006 e ka pasur në përdorim dhe pronar i saj është bërë në vitin 2007. Ai theksoi se për blerjen e makinës ka firmosur i vëllai në emrin e tij, duke ngritur pyetje dhe dyshime tek trupi gjyqës. Në vitin 2007 është lënë nga subjekti në një servis, duke u përdorur prej tyre dhe është bërë një aksident. Pas tij është bërë rregullimi dhe i janë vënë targa të reja shqiptare. Subjekti deklaroi se ia ka shitur baxhanakut dhe vëllait të tij më kontratë huapërdorje. Në datë 21.09.2010 është ndaluar nga policia dhe ka rezultuar makinë e vjedhur, duke u sekuestruar makina, letrat kanë rezultuar të falsifikuara. Subjekti pohoi që në vitin 2006 ka pasur të ardhura të mjaftueshme (1 milion 865 mijë lekë) për të blerë makinën. Lidhur me kartën e debitit të përdorur nga i vëllai, në shumën 317 mijë lekë deklaroi se kjo shumë ishte e paguar nga e motra që jetonte në Amerike, e cila ka financuar shkollimin e vëllait në Itali. Lidhur me analizën financiare të vitit 2006 rezultojnë 626 mijë e 26 lekë në total, me tepër nga të ardhurat që ka nxjerr KPK. Lidhur me kredinë e marrë në shumën prej 50 mijë euro në Tirana Bank, ai i konsideroi si formë kursimi për të vënë pasuri të paluajtshme. Shuma i është kaluar shoqërisë "S.M.O" në mirëbesim dhe nëse do të binin dakord do të bëhej kontratë noteriale, gjë që nuk u arrit të bëhej. Marrëveshja nuk është deklaruar por shuma e marrë kredi po.</p>	Subjekti	

		Ankesa nga publiku	
		ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	DSIK në raportin e parë e ka cilësuar subjektin si të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe në raportin e përditësuar e ka cilësuar si të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Raporti cilëson përfshirjen e subjektit në veprën penale të korrupsionit pasiv dhe lirim të një personi të dënuar me vendim për kryerjen e një veprë penale si vrasje.	Të dhëna nga raportet e DSIK	
	KPK në hetimin e thelluar të tij ka arritur në përfundimin se subjekti ka lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin.	Relatori	
	E drejta për të pasur akses në informacionin e cilësuar si sekret shtetëror në vendet e tjera njihet si privilegj ndërsa tek ne çënohet kjo e drejtë. Sipas av. Visha ky raport nuk e respekton ligjin dhe bie në kundërshtim me të. Kontakti i papërshtatshëm duhet të bëhet i ditur. E quajmë të padrejtë mosnjohjen e aktit (raportit).	Mbrojtja	
	Ngriti pretendimin se nuk ishte njohur me asnjë provë që shoqëronte raportin negativ të DSIK-së. Sipas tij raporti nuk kishte një strukturë të caktuar ligjore duke cituar nenet përkatëse të Kushtetutës dhe Ligjit. Sipas tij në raport përdoret fjala "dyshon" fjalë të cilën vetë Kushtetuta se pranon. Sipas tij nuk mund të jetë sekret vendim i dhënë prej tij dhe i publikuar.	Subjekti	
		Ankesa nga publiku	
		ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës		Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	
		Relatori	
		Mbrojtja	
		Subjekti	
<b>E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</b>	Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z. Arben Zefi, kryetar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Shkodër zgjati rreth 2 ore, duke u paraqitur e rregullt, në respektim të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm. Pati kontestime, pyetje nga anëtarët e trupës gjyqësore, kundërshtime nga subjekti i rivlerësimit dhe mbrojtësi ligjor. Anëtarja e trupës zj. Ciftja i drejtoi disa pyetje subjektit të rivlerësimit lidhur me faktin sesi e justifikonte përdorimin e kartës së tij të debitit nga vëllai i tij në Itali dhe si mundet që marrëdhëniet de facto i quan më të pranueshme sesa ato de jure. Pyetje të cilat ndeshën qëndrimin e subjektit. Gjatë shqyrtimit të seancës dëgjimore u trajtuan dy kriteret e gjykimit të procesit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit pohoi se ishte njohur dhe kishte marrë në dorëzim materialet e dosjes. I ishte kaluar barra e provës dhe trupi gjyqësor pohoi që ishin marrë në shqyrtim provat e sjella. Kryesuesja e trupit gjyqësor ndërhyri gjatë fjalës së subjektit të rivlerësimit lidhur me komponentin e figurës, e cila cilësoi se KPK bën hetim të thelluar dhe të pavarur nga institucionet ndihmesë të saj dhe se raportet e ILDKPKI-së dhe DSIK-së nuk çënojnë hetimin e thelluar të KPK-së. Relatori i çështjes në fjalën e tij nuk përmendi ankesa dhe numrin e tyre të ardhur në emër të subjektit z. Arben Zefi. Trupi gjyqësor në asnjë moment nuk shkeli rregullat e etikës, profesionalizmit dhe nuk u vërejtën probleme të kësaj natyre. Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të paraqitej me mbrojtës ligjor z. Ardian Visha. Nuk u konstatua asnjë shkelje, paragjykim apo presione të ndryshme gjatë seancës. Përmasat e sallës në pallatin e Koncerteve (ish pallati i Kongreseve) garantojnë respektimin e plotë të standardeve të një seance publike. Trupi gjyqësor u tërhoq duke caktuar datën 10.01.2019 ora 12:00 për shpalljen e vendimit.		